

V E N D I M
Nr. 24, datë 24.11.1993

PËR BUXHETIN E SHTETIT TË PERIUDHËS JANAR-SHKURT 1993

Në mbështetje të nenit 20 të ligjit “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet Buxheti i shtetit për periudhën janar-shkurt 1993, i paraqitur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë me të ardhura 2 miliardë e 525 milionë lekë dhe shpenzime 5 miliardë lekë, sipas pasqyrave nr.1 dhe nr.2 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

Neni 2

Deficiti i buxhetit të shtetit për periudhën janar-shkurt 1993 parashikohet të jetë 2 miliardë e 475 milionë lekë.

Neni 3

Deficiti i buxhetit të shtetit për periudhën janar-shkurt parashikohet të bulohet tërësisht nga kredia e brendshme bankare për financimin e shpenzimeve për shumën 2 miliardë e 475 milionë lekë.

Neni 4

Të ardhurat tatimore nga sektori shtetëror do të jenë 1 miliardë e 380 milionë lekë.

Neni 5

Të ardhura të tjera nga tatime e taksa parashikohen 615 milionë lekë, ndër të cilat taksa doganore 230 milionë lekë.

Neni 6

Të ardhurat nga shitja e ndihmës së huaj ushqimore në buxhetin e shtetit të janar-shkurtit 1993 janë parashikuar të jenë 530 milionë lekë.

Neni 7

Nëse të ardhurat nuk realizohen në masën e parashikuar në buxhetin e vitit 1992, shpenzimet do të ulen në të njëjtën masë.

Neni 8

Shpenzimet e buxhetit të shtetit për periudhën janar-shkurt 1993 për sektorët e shërbimeve shoqërore arsim-kulturë caktohen 746 milionë lekë, për shëndetësinë 537 milionë lekë dhe për sigurimet shoqërore 803 milionë lekë.

Neni 9

Për përkrahjen sociale në buxhetin e shtetit të periudhës janar-shkurt 1993 do të jenë 910 milionë lekë, ndër të cilat 810 milionë lekë për përfitim papunësie e 60 milionë programi i uljes së

varfërisë.

Neni 10

Për mbrojtjen e vendit në buxhetin e shtetit të periudhës janar-shkurt 1993 parashikohen 524.7 milionë lekë.

Neni 11

Për ruajtjen e rendit publik në buxhetin e shtetit të periudhës janar-shkurt 1993 janë caktuar 255 milionë lekë.

Neni 12

Për buxhetin e shtetit të periudhës janar-shkurt 1993 për organet e drejtësisë janë caktuar 10 milionë lekë.

Neni 13

Subvencionet e çmimeve të parashikuara në buxhetin e shtetit të periudhës janar-shkurt 1993 do të jenë 290 milionë lekë.

Neni 14

Investimet në buxhetin e shtetit të periudhës janar-shkurt 1993 do të jenë 488 milionë lekë.

Neni 15

Ky buxhet do të jetë i vlefshëm deri në miratimin e buxhetit vjetor nga Parlamenti.

Neni 16

Të gjitha ministrinë ngarkohen të marrin masa për zbatimin e tij.

Neni 17

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV. KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISRAVE
Bashkim Kopliku